



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0955

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Vedat Poterqoi dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtarë të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së OE “SEFERI-CO” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë” me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA SUHAREKË”, më 14/11/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht ankesa e “SEFERI-CO” SH.P.K. me nr. 2025/0955, e datës 25/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë”, me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË”. AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.
2. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si pjesërishtë, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.05.2025, “KOMUNA SUHAREKË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë” me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1,300,000.00 €.

Me 18.09.2025, OE “SEFERI-CO” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 25/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “SEFERI-CO” SH.P.K me nr. 2025/0955 lidhur me aktivitetin Projekt me bashkfinancim - Ndertimi idevijiit te rruges Magjistrale ne fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges per tek varrezat e reja te fshatit Bllacë-Suharekë” me numër të prokurimit 624-25-4485-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Kosovës ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2025/0624 i dt: 08.09.2025.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “SEFERI-CO” SH.P.K Përgjegje ne pretendimve ankimore Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të dorëzuar nga Operatori Ekonomik ankues, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet e paraqitura janë të pabazuara. Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë masat e nevojshme korngjuese duke u bazuar në ekspertizën e lëndës dhe në vendimin e nxjerrë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSI IP).

Duke u bazuar në nenet 62 dhe 63 të Rregullores për Prokurim Publik dhe nenet përkatëse të LPP-së, Autoriteti Kontraktues refuzon kërkesën për nshqyrtim si të pabazuar, andaj ky aktiviteti është korngjuar në përputhje me ekspertizën dhe vendimin e OSHP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SEFERI-CO” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Duke marrë parasysh faktin se Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij mbi kërkesën tone(datës 22.09.2025) për rishqyrtim, për asnjë nga pretendimet e ngritura nuk ka dhënë asnjë përgjigje të argumentuar,ose ka dhënë vetëm përgjigje sipërfaqësore dhe të përgjithshme pa bazë ligjore apo teknike, atëherë të gjitha pretendimet e të ngritura në kërkesën tonë për rishqyrtim mbeten plotësisht në fuqi, të paadresuara dhe pa ndonjë kundërshtim të vlefshëm nga ana e AK-së.

Në këtë drejtim, pretendimet tona të patrajuara ruajnë vlerën dhe efektin e tyre të plotë ligjor dhe procedural, duke u konsideruar si pjesë integrale e kësaj ankese të parashtruar pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Rrjedhimisht, kërkojmë që OSHP të trajtojë këto pretendime, bazuar drejtpërdrejt në përmbajtjen origjinale të kërkesës sonë për rishqyrtim, pasi ato vazhdojnë të jenë plotësisht të pazgjidhura dhe të pakontestuar në mënyrë të duhur nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues (AK) veproi në kundërshtim me:

Vendimin e OSHP nr. 0624/2025,

Raportin e Ekspertit nr. 0624/2025, si dhe

Rekomandimin e Departamentit të Monitorimit të KRPP, të datës 04.06.2025, ora 09:27, i cili ka sugjeruar korrigjime në Dosjen e Tenderit.

Edhe pas shqiptimeve të vërejtjeve nga Paneli Shqyrtues, i cili theksoi nevojën që AK të përmbahet në tërësi ndaj dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë korrigjime të plota në Dosjen e Tenderit. Janë kryer vetëm disa ndryshime minimale, të cilat nuk reflektojnë respektimin e plotë të vendimit të OSHP dhe rekomandimeve të KRPP

Kërkesa:

Ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

të respektojë në tërësi vendimin e OSHP nr. 0624/2025;

të zbatojë rekomandimet e Departamentit të Monitorimit të KRPP; të bëjë korrigjimet e plota në Dosjen e Tenderit sipas këtyre udhëzimeve, duke siguruar që ajo të jetë në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik. Ne vijim do të parqesim Kërkesa Kjo kërkesë teknike e vendosur nga Autoriteti Kontraktues (AK) për Menaxherin e Projektit është diskutabile dhe nuk qëndron ligjërisht për aktivitetin konkret të prokurimit – ndërtimi i rrugës.

Më poshtë po e analizojmë në mënyrë të strukturuar dhe të argumentuar:

Përshkrimi i kërkesës së AK-së:

Menaxheri i Projektit duhet të jetë:

Inxhinier i diplomuar në Ndërtimtari ose Master – drejtimi konstruktiv,

Me përvojë pune min. 10 vite pas diplomimit

I certifikuar si mbikëqyrës saldimi sipas ISO 14731 ("Welding supervisor")

Vlerësim teknik dhe ligjor i kërkesës:

1. Mosrelevanca me llojin e projektit – ndërtim rruge

Aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e rrugës, i cili zakonisht përfshin:

Punë gërmimi,

Punë të trupit të rrugës,

Punë asfalti,

Punë të kanalizimeve dhe mbrojtjes rrugore.

Në të tilla projekte, nuk ka nevojë domosdoshmërisht për punë saldimi të çertifikuara sipas ISO 14731, aq më pak që kjo të jetë kriter për menaxherin e projektit.

ISO 14731 lidhet me supervizimin teknik të saldimeve, e cila është më e përshtatshme për:

Punë metalike të sofistikuara (p.sh., ura metalike, struktura të çelikut, objekte industriale), Jo për ndërtim të zakonshëm rrugor.

2. Kriter i paproporcional dhe diskriminues

Sipas nenit 7 të LPP (Ligji për Prokurimin Publik) dhe udhëzimeve të KRPP-së:

"Kriteret e kapacitetit duhet të jenë të lidhura ngushtë me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të prokurimit dhe të jenë të arsyeshme, proporcionale dhe jo-diskriminuese."

Kërkesa për ISO 14731 për Menaxherin është:

E palidhur me objektin e kontratës;

Jo proporcionale për nivelin e përgjegjësisë së menaxherit (i cili mbikëqyr projektin në tërësi, jo specifikisht saldimet).

3. Përzierje e roleve teknike

Certifikimi ISO 14731 ka të bëjë me personat që janë përgjegjës teknikisht për cilësinë e saldimit (teknik saldimi / mbikëqyrës saldimi).

Ky rol nuk i takon menaxherit të projektit, por ndonjë inxhinieri specifik të saldimeve, nëse punët e tilla ekzistojnë në projekt.

Çfarë do të ishte kërkesë e drejtë dhe e ligjshme?

Menaxheri i Projektit – Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose Master në fushën përkatëse, me përvojë të paktën 10 vite në projekte të ngjashme të ndërtimit të rrugëve.

Kërkesë për largim/modifikim të kësaj pike:

Kërkojmë që kërkesa për çertifikim "Welding supervisor according to ISO 14731" për Menaxherin e Projektit të largohet nga Dosja e Tenderit, pasi është kriter jo i ndërlidhur me objektin e kontratës, joproporcional dhe kufizues për konkurrencën, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe udhëzimet e KRPP-së për hartimin e kriterëve teknike.

KËRKESË PËR RISHQYRIM

Lidhur me mbivendosjen e pozitës 3.4 me pikat 3.1.1 dhe 3.2 të Dosjes së Tenderit nderuar Autoritet Kontraktues, Duke shqyrtuar dokumentacionin e tenderit, konkretisht kërkesat për stafin teknik, kemi

vërejtur se në pikën 3.4 është kërkuar:

"Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;"

Kjo kërkesë rezulton të jetë në mbivendosje të qartë dhe të pajustificuar me dy pozita të tjera të përcaktuara më herët në dokument:

Pika 3.1.1 – Menaxheri i Projektit: Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë / master – drejtimikonstruktiv, me min. 10 vite përvojë, dhe me certifikim ISO 14731.

Pika 3.2 – Udhëheqësi i Punishtes: Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë / master – drejtimikonstruktiv, me min. 5 vite përvojë.

Të gjitha këto pozita kërkojnë praktikisht të njëjtën kualifikim arsimor dhe përvojë profesionale, përveç se menaxheri ka një periudhë më të gjatë përvojë dhe një certifikim shtesë (të cilëngjithashtu e kemi kontestuar në pikë tjetër).

Vlerësimi profesional dhe ligjor:

Mbivendosje funksionale dhe përmbajtjesore Kërkesa për tre pozita të ndara (3.1.1, 3.2 dhe 3.4) me të njëjtin profil teknik përbën mbivendosje të pajustificuar, pasi në praktikën e zakonshme të projekteve të ndërtimit të rrugëve, këto role mbulojnë nga 1 ose 2 persona me kualifikim të tillë, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të projektit.

Kriter joproporcional dhe diskriminues Vendosija e tre pozitave me të njëjtin profil, pa ndarje të qartë të përgjegjësi dhe pa justifikim teknik për rolin e veçantë të pozitës 3.4, përbën shkelje të nenit 7 të LPP-së, i cili kërkon që kriteret të jenë:

Të lidhura me objektin e kontratës;

Të arsyeshme dhe proporcionale;

Të pa-diskriminuese.

Shkelje e udhëzuesit të KRPP-së për kriteret teknike

Sipas udhëzuesit për përgatitjen e dosjes së tenderit, AK nuk duhet të vendosë kritere që dublon rolet teknike dhe që vendosin kufizime të panevojshme ndaj konkurrencës.

Kërkesa jonë konkrete:

Kërkojmë që:

Pika 3.4 të largohet nga Dosja e Tenderit si pozicion i veçantë, pasi është në mbivendosje të plotë me pozitën e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, të cilët tashmë mbulojnë të gjitha kapacitetet e nevojshme profesionale;

Në rast se Autoriteti Kontraktues vlerëson që nevojitet një person shtesë, atëherë të lejohet kombinimi i roleve teknike nëse i njëjti person përmbush kriteret për më shumë se një pozitë;

Të bëhet riformulimi i kërkesave të stafit teknik në përputhje me natyrën e kontratës, praktikën e mirë të prokurimit dhe nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

“Bachelor i Diplomuar i Arkitekturës, me përvojë pune min. 5 vite.”

Kërkojmë që kjo kërkesë të riformulohet në formën më gjithëpërfshirëse dhe përjashtuese të diskriminimit të kuadrove me kualifikime të larta, duke u shprehur si më poshtë:

“Bachelor ose Master i Diplomuar i Arkitekturës, me përvojë pune min. 5 vite.”

Arsyetimi i kërkesës:

Kriter i kufizuar në mënyrë të pajustificuar Kërkesa ekzistuese përjashton kandidatët që kanë përfunduar studimet master në Arkitekturë, ndonëse ata kanë një nivel më të lartë të përgatitjes akademike dhe profesionale se sa niveli Bachelor.

Kjo është në kundërshtim me qëllimin e kriterëve, të cilat duhet të përcaktojnë minimumin e kërkuar, jo të përjashtojnë nivele më të avancuara.

Shkelje e nenit 7 të Ligjit për Prokurimin Publik

Sipas këtij neni, kriteret e kapacitetit duhet të jenë:

“...të lidhura me objektin e kontratës, proporcionale dhe jo-diskriminuese.”

Përjashtimi i kandidatëve me Master të Arkitekturës është i paarsyeshëm, i joproportional dhe diskriminues ndaj një kategorie profesionistësh më të kualifikuar.

Përputhshmëria me praktikat standarde të prokurimit

Në të gjitha dokumentet model dhe udhëzuesit e KRPP-së për hartimin e kriterëve të stafit teknik, nuk parashihet ndalimi i përfshirjes së kandidatëve me kualifikime më të larta.

Për më tepër, në shumicën e tenderëve, formatimi standard është: “Bachelor ose Master në fushën përkatëse”.

Kërkesa konkrete:

Kërkojmë që kriteri për profilin e arkitektit të riformulohet në këtë mënyrë:

“Bachelor ose Master i Diplomuar i Arkitekturës, me përvojë pune min. 5 vite.”

Gjysmërimorkio me kapacitet ngarkese prej 65–70 ton”

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Duke u bazuar në nenin 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), ne si Operator Ekonomik i interesuar, parashtruar këtëkërkesë për rishqyrtim lidhur me një kriter specifik të vendosur në dosjen e tenderit, për të

cilinkonsiderojmë se është i pajustificuar teknikisht, kontradiktor, dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik.

1. Objekti i kontestimit

Në dokumentet e tenderit është paraparë kërkesa për:

“Gjysmërimorkio me kapacitet ngarkese prej 65–70 ton”

Kjo kërkesë, sipas interpretimit dhe përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Kontraktues ndaj pyetjeve tona paraprake, ka rezultuar e paqartë dhe kontradiktore, si dhe pa bazë teknike të justifikuar.

2. Argumentet tona

a) Paqartësi dhe kontradiktë në përgjigjen e dhënë nga AK

Në përgjigjen zyrtare të dhënë nga AK, është deklaruar njëherë se bëhet fjalë për kapacitetin total të transportit të kombinuar (mjet + rimorkio + ngarkesë), ndërsa në pjesën tjetër të përgjigjes thuhet se kriteri ka të bëjë me aftësinë për të transportuar pajisje të rënda (p.sh. ekskavatorë 50–65 ton). Kjo është një kontradiktë logjike, pasi nëse kapaciteti 65–70 ton është total, atëherë është e pamundur të transportohen pajisje të vetme me peshë 50–65 ton.

b) Mungesë përputhjeje me legjislacionin për transport

Në rast se parashihet transport i pajisjeve me peshë kaq të rëndë, atëherë është e domosdoshme që të parashikohen edhe:

Leje speciale për tejkalim të peshës,

Shoqërim i posaçëm sipas ligjit për transport rrugor, dhe

Analizë e itinerarit për kapacitet mbajtës të rrugës.

Asnjëra nga këto kërkesa nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit, që tregon se kërkesa është vendosur në mënyrë formale, pa përputhje me realitetin praktik dhe ligjor.

c) Mungesë justifikimi teknik në dokumentet e tenderit

Në paramasë dhe specifitime teknike, nuk ka asnjë pozicion që kërkon transport të pajisjeve me peshë 50–65 ton, që do të arsyetonte nevojën për këtë lloj gjysmërimorkio. Pra, nuk ekziston lidhja funksionale midis kërkesës dhe objektit të kontratës.

3. Vlerësimi ligjor i kriterit të kontestuar

Kjo kërkesë bie në kundërshtim me:

Nenin 7 të LPP-së – për shkak se nuk është as proporcionale dhe as e qartë;

Nenin 67.6 të LPP-së – sepse nuk ofron zgjidhje teknike alternative dhe favorizon vetëm një lloj mjeti specifik;

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – i cili kërkon që kriteret teknike:

“Të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen teknikisht.”

Në këtë rast, kërkesa nuk është e lidhur me nevojat reale të kontratës dhe nuk është e arsyetuar në mënyrë të dokumentuar.

4. kërkesa jonë

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë ose riformulojë kriterin për “gjysmërimorkio m kapacitet 65–70 ton”, duke e bërë atë:

Opsional ose me përshkrim më të përgjithshëm, ose Të zëvendësohet me një kriter proporcional, të lidhur me nevojat reale të projektit(gjysmërimorkio me peshe bartese 30–50 ton)

Në të kundërt, mbajtja e këtij kriteri në formën aktuale përbën pengesë për konkurrencë të ndershme, dhe është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Mungesë trajtimi në kërkesën e parë për rishqyrtim

Dëshirojmë të theksojmë se ky pretendim është ngritur nga ne edhe në kërkesën e parë për rishqyrtim, mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje apo trajtim mbi këtë çështje, duke vepruar në kundërshtim me:

Nenin 108/A paragrafi 4 i LPP-së, i cili detyron Autoritetin Kontraktues të japë një arsyetim të plotë, të drejtë dhe të argumentuar për secilën pikë të ngritur nga operatori ekonomik.

Mungesa e trajtimit e bën këtë kriter formalisht të kontestueshëm edhe për mosrespektim të procedurës, përveç problematikës përmbajtësore që paraqet.

3. Argumentet tona për përmbajtjen e kriterit

a)Paqartësi dhe kontradiktë në përgjigjen e dhënë nga AK ndaj pyetjes për sqarim

Në përgjigjen zyrtare të dhënë nga AK, është deklaruar njëherë se bëhet fjalë për kapacitetin total të transportit të kombinuar (mjet + rimorkio + ngarkesë), ndërsa më pas përmendet aftësia për të transportuar ekskavatorë 50–65 ton.

Kjo është një kontradiktë logjike, sepse nëse kapaciteti total është 65–70 ton, nuk mund të transportohet një ekskavator i vetëm që peshon po aq ose më shumë se vetë kufiri i kapacitetit të deklaruar.

b) Mungesë përputhjeje me legjislacionin për transport

Nëse kërkohet transport i pajisjeve të rënda (si ekskavatorë 50–65 ton), atëherë duhet të përfshihen:

Leje speciale për tejkallim të peshës,

Shoqërim sipas ligjit për tejkallim të ngarkesës në rrugë publike,

Vlerësim i itinerarit për kapacitetin mbajtës të rrugëve.

Asnjëra nga këto nuk është përmendur në dosje – prandaj kërkesa është jashtë përputhjes me realitetin teknik dhe ligjor.

c) Mungesë justifikimi në paramasë dhe specifikime teknike

Në asnjë vend të paramasës apo specifikimeve teknike nuk parashihet transport i pajisjeve me peshë 50–65 ton, prandaj kjo kërkesë është e paprovuar teknikisht dhe nuk ka asnjë lidhje me përmbajtjen e kontratës.

4. Vlerësim ligjor

Kjo kërkesë bie në kundërshtim me:

Nenin 7 të LPP-së – për shkak se nuk është as proporcionale, as e qartë, dhe nuk kontribuon në realizimin e objektivit të kontratës;

Nenin 67.6 të LPP-së – sepse nuk ofron alternativa teknike të barabarta dhe favorizon një zgjidhje të vetme, duke e kthyer në kriter diskriminues;

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – që kërkon që çdo kriter teknik të jetë:

“i lidhur drejt me përmbajtjen e kontratës dhe i justifikuar teknikisht.”

“2 copë ekskavatorë për gërmim me peshë minimale 65 ton.”

1. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim

Në kërkesën tonë për sqarim të dorëzuar më herët, kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues të qartësojë këto çështje themelore:

Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që kërkojnë përdorimin e ekskavatorëve me peshë mbi 65 ton?

Cili është justifikimi teknik për kërkesën për dy pajisje me këtë kapacitet ekstrem?

A është bërë vlerësim i ngarkesës operative që dëshmon nevojën për dy pajisje të kësaj mase, dhe jo alternativa të tjera të zakonshme?

A janë të pranueshme zgjidhje teknike të krahasueshme me kapacitete 30–40 ton?

A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024?

2. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues

Në shtojcën e përgjigjeve, AK nuk ka ofruar përgjigje të plotë, të qartë dhe të drejtpërdrejtë për secilën pyetje të ngritur:

Nuk është identifikuar asnjë pozicion konkret në paramasë, si p.sh. pozitat 3.01 apo 3.02, që të justifikojë përdorimin e pajisjeve 65 ton;

Nuk është paraqitur ndonjë analizë teknike për natyrën e terrenit (p.sh. shkëmbinj, kompaktësi, thellësi) që do të kërkonte pajisje të kësaj mase

Përgjigja është e përgjithësuar, e paarsyetuar teknikisht, dhe nuk përmbush detyrimin për sqarim objektiv, transparent dhe proporcional.

3. Vlerësim teknik dhe faktik

Pozitat 3.01 dhe 3.02 të paramasës përfshijnë gërmime në kategori dheu III, IV dhe V (humus dhe dhe), të cilat zakonisht përpunohen me ekskavatorë 20–40 ton, që janë pajisje standarde në projekte të këtij lloji.

Kërkesa për 2 ekskavatorë me peshë mbi 65 ton nuk përputhet me:

Volumin e punimeve,

Natyrën e terrenit, apo

Urgjencën e afateve të zbatimit.

AK nuk ka arsyetuar se përse kombinimi i dy pajisjeve të klasës 30–40 ton, ose përdorimi i një pajisjeje të kësaj mase në mënyrë të njëpasnjëshme, nuk do të ishte i mjaftueshëm.

4. Vlerësim ligjor

Kërkesa në fjalë bie ndesh me këto dispozita:

Neni 7 i LPP-së – Parimi i proporcionalitetit dhe qartësisë

Kriteri i vendosur është joproporcional me objektin e kontratës, sepse vendos kufizim pa nevojë reale teknike.

Neni 67.6 i LPP-së

Nuk ofron alternativa teknike të pranueshme, duke favorizuar vetëm një klasë specifike pajisjeje pa justifikim funksional.

Neni 19.2 i Rregullores 002/2024

“AK mund të kërkojë pajisje vetëm nëse është e nevojshme për përmbushjen e kontratës, dhe duhet të përshkruajë lidhjen ndërmjet kërkesës dhe përmbajtjes së kontratës.”

Në këtë rast, nuk është dhënë asnjë lidhje konkrete ndërmjet kërkesës dhe pozitave në paramasë, siç kërkohet me rregull.

5. Kërkesa jonë konkrete

Duke u bazuar në analizën e mësipërme, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

Të largojë nga dosja e tenderit kriterin për “2 copë ekskavatorë me peshë minimale 65 ton”, për arsye se:

Nuk ka bazë teknike në dokumentet e projektit (paramasë dhe specifikime);

Nuk është proporcionale dhe objektive me natyrën e punimeve;

Është në kundërshtim me LPP-në dhe Rregulloren 002/2024.

Në vend të kësaj, të zëvendësohet me kërkesë më proporcionale, si

“2 copë ekskavatorë për gërmim me peshë 30–40 ton”

Cilindër vibrues (makinë ngjeshëse) me peshë minimale 26 ton.”

1. Pyetjet tona të parashtruara për sqarim

Në kërkesën për sqarim të dorëzuar më parë, kemi ngritur pyetje të drejtpërdrejta që kanë synuar të kuptojnë arsyeshmërinë dhe bazën teknike të kësaj kërkesë, si më poshtë:

Cila është arsyeja teknike që justifikon përdorimin e një cilindri mbi 26 ton për shtresa standard rëre, tamponi dhe mbushje?

A është bërë ndonjë analizë laboratorike e ngjeshshmërisë që imponon këtë peshë pajisjeje?

A mund të përdoren alternativa me performancë të barasvlershme (cilindër 13–20 ton)?

A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024?

2. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues

Në shtojcën e përgjigjeve, AK nuk ka ofruar sqarime të qarta, konkrete dhe teknike për asnjë nga pyetjet e ngritura. Më konkretisht:

Nuk janë përmendur pozitat specifike të paramasës (si 3.06–3.08) që do të kërkonin pajisje 26 ton;

Nuk është ofruar asnjë analizë laboratorike apo vlerësim teknik i nevojës për këtë kapacitet;

Nuk është përmendur asnjë alternativë teknike e krahasueshme (p.sh. cilindër 13–20 ton me vibrosistem të avancuar);

Përgjigjet janë të përgjithshme dhe nuk adresojnë nevojën reale teknike për këtë specifikim.

3. Vlerësim teknik

Pozitat 3.06–3.08 të paramasës përfshijnë punime si:

Ngjeshje të shtresave të rërës, tamponit dhe materialeve mbushëse,

Shtresa standarde për ndërtim rrugor (trashësi dhe kompaktësi e zakonshme),

Punime që në praktikën ndërtimore ekzekutohen me sukses me cilindër vibrues 13–20 ton.

Sistemet moderne të ngjeshjes (cilindra me frekuencë të rregullueshme, amplitudë të dyfishtë,

testues dinamik të ngjeshjes) janë të aftë të arrijnë kërkesat e modulit $Ev2/Ev1 \geq 2.2-2.5$, pa pasur nevojë për peshë fizike ekstreme të makinës.

4. Vlerësim ligjor dhe përputhje me rregulloret

Ky kriter bie në kundërshtim me:

Nenin 7 të LPP-së

Kërkesa është joproportionale dhe vendoset pa lidhje të drejtëpërdrejtë me përmbajtjen e kontratës, duke kufizuar pjesëmarrjen e OE-ve që përdorin pajisje të zakonshme në treg.

Nenin 67.6 të LPP-së

Nuk ofrohen zgjidhje teknike alternative si për shembull: përdorimi i pajisjeve të tjera që arrijnë të njëjtën performancë ose testime laboratorike për përmbushjen e standardeve.

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024

Kjo dispozitë kërkon që kërkesat teknike të:

“Të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikohen teknikisht.”

Në këtë rast, nuk është përmendur asnjë dokument teknik, analizë terreni apo vlerësim profesional që e mbështet këtë kërkesë.

5. Kërkesa jonë konkrete

Duke u bazuar në sa më sipër, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

Të largojë kërkesën për “cilindër vibrues me peshë minimale 26 ton”, pasi:

Nuk ka arsyetim teknik të dokumentuar,

Nuk përputhet me natyrën dhe përmasat e projektit,

Nuk është në përputhje me ligjin dhe rregulloren përkatëse.

Kjo kërkesë mund të zëvendësohet me një formulim më proporcional si:

“Cilindër vibrues për ngjeshje, me peshë 13–20 ton, (pika 11 te ankesi 8 lista e makineris e) me frekuencë të rregullueshme dhe kapacitet për arritjen e moduleve të ngjeshjes të kërkuara sipas specifikimeve teknike.” Ose të larohet komplet si pasije pasi që në piken 11 janë kërkuar 3 cilindër 12-20 ton

“3 copë ngarkues (kapacitet 3–4 m³)”

1. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim

Në kërkesën tonë zyrtare për sqarim kemi ngritur pyetjet në vijim:

Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që justifikojnë përdorimin njëkohësisht të 3 ose më shumë ngarkuesve 3–4 m³?

A ekziston ndonjë analizë e fluksit të materialeve që vërteton se janë të domosdoshëm 3–4 ngarkues paralelisht?

A mund të përmbushet funksioni i ngarkimit me numër më të reduktuar ngarkuesish, në kombinim me ekskavatorët e shumtë të kërkuar tashmë në dosje?

A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-së, si dhe me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkojnë justifikim teknik të verifikueshëm dhe proporcional?

2. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues

Në përgjigjen e dhënë, Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar sqarime konkrete, teknike dhe të lidhura me objektin e kontratës. Në veçanti:

Nuk janë përmendur pozita të paramasës që kërkojnë angazhim paralel të 3 ngarkuesve;

Nuk është ofruar asnjë vlerësim i fluksit të materialit që do të përpunohet apo bartet;

Nuk është shqyrtuar mundësia e zëvendësimit të ngarkuesve me ekskavatorë ose pajisje të tjera të kërkuara tashmë në Aneksin 8, që kryejnë funksione të ngjashme të gërmim/ngarkimit.

3. Vlerësim teknik

Materialet që përpunohen në këtë projekt janë standarde për ndërtim rrugor (rërë, zhavor, mbushje, etj.) dhe përpunohen me pajisje standarde, në fazat e ndërtimit dhe jo njëkohësisht

Në Aneksin 8 të dosjes janë të kërkuara një numër i madh ekskavatorësh (përfshirë edhe ato me kapacitet 50–65 ton), të cilët në praktikë mbulojnë një pjesë të konsiderueshme të funksioneve të ngarkuesve;

Në mungesë të një analize të fluksit të materialeve ose vëllimit të punimeve, kërkesa për 3 copë ngarkues të kësaj klase është e pajustificuar teknikisht dhe bie në kundërshtim me praktikën profesionale të ndërtimit rrugor.

4. Vlerësim ligjor

Ky kriter është në kundërshtim me dispozitat e mëposhtme:

Neni 7 i LPP-së

Vendosja e një kërkesë të tillë pa justifikim teknik përbën shkelje të parimit të proporcionalitetit dhe barazisë në trajtim, duke e bërë kriterin kufizues për konkurrencë.

Neni 59.3 dhe 67.6 i LPP-së

Autoriteti Kontraktues nuk ka parashikuar mundësinë e zëvendësimit funksional, p.sh. përdorimi i 2 ngarkues + 1 ose 2 ekskavatorë, që do të arrinin të njëjtin kapacitet funksional.

Neni 19.2 i Rregullores 002/2024

“Kriteret teknike duhet të jenë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të jenë të justifikuar në mënyrë të verifikueshme.”

Kjo nuk është përmbushur në këtë rast, sepse nuk ka dokumentacion mbështetës që e lidh sasinë dhe kapacitetin e kërkuar me nevojat reale të kontratës.

5. Kërkesa jonë konkrete

Duke u bazuar në analizën teknike dhe ligjore të mësipërme, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues:

Të ndryshojë kërkesën aktuale, si vijon:

Nga: “3 copë ngarkues 3–4 m³”

Në: “2 copë ngarkues me kapacitet minimal 4 m³”,

ose të lejojë kombinim alternativ me pajisje të ngjashme që përmbushin funksionin e njëjtë (p.sh. 1 ngarkues + 1 ekskavator për ngarkim).

Kjo do të siguronte:

Zbatim të drejtë të parimit të proporcionalitetit;

Nxitje të konkurrencës së barabartë në treg;

Përputhje të kriterit me nevojat reale dhe objektin e kontratës, siç kërkohet nga LPP dhe Rregullorja 002/2024

Ngarkues me kapacitet minimal 60 ton”

1. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim

Cilat janë pozicionet konkrete në paramasë që justifikojnë përdorimin e një ngarkuesi me kapacitet 60 ton?

A është bërë ndonjë analizë teknike mbi fluksin ose dinamikën e punimeve që kërkon një ngarkues kaq të madh?

A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, si dhe me nenin 19.2 të rregullores 002/2024, që kërkojnë proporcionalitet dhe lidhje të drejtëpërdrejtë me objektin e kontratës?

2. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues

AK nuk ka dhënë përgjigje për pozita të paramasës që kërkojnë kapacitet 60 ton;

Nuk është ofruar asnjë analizë teknike mbi nevojën reale të kapacitetit ekstrem;

Përgjigja është e përgjithshme, duke mos treguar nëse funksionet e ngarkuesit nuk mund të realizohen me pajisje 20–30 ton;

AK referon Vendimin e OSHP 0837/2024, duke argumentuar se Operatorët Ekonomikë mund të përdorin edhe marrëveshje për qira të makinerisë, çka nuk kundërshtohet në këtë kërkesë për rishqyrtim.

3. Vlerësim teknik

Materialet që përpunohen janë standarde për ndërtim rrugor (zhavor, mbushje, rërë, tampon);

Ngarkuesit 20–30 ton janë standardi praktik dhe përdoren gjerësisht në industri dhe ndërtim lokal;

Një ngarkues 60 ton nuk ka lidhje me pozitat konkrete të punimeve, nuk është praktik, dhe nuk ofron ndonjë përfitim teknik të justifikueshëm për projektin;

Mund të realizohen të njëjtat funksione me ngarkues standard 25 ton, duke siguruar kapacitet të mjaftueshëm dhe fleksibilitet operativ.

4. Vlerësim ligjor

Ky kriter bie ndesh me:

Neni 7 i LPP-së

Vendos kriter joproportional, që kufizon pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë pa bazë teknike.

Neni 59.3 dhe 67.6 i LPP-së

Nuk siguron zgjidhje alternative dhe nuk mbështetet në analizë objektive të nevojës.

Neni 19.2 i Rregullores 002/2024

Kriteri teknik nuk është i lidhur me objektin e kontratës, nuk ka dokumentacion teknik që e justifikon.

5. Kërkesa konkrete për rishqyrtim

Duke u bazuar në argumentimin teknik dhe ligjor:

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë kërkesën për “ngarkues me kapacitet minimal 60 ton”, dhe të zëvendësohet me pajisje më të zakonshme që përdoren në praktikën ndërtimore:

“Ngarkues me kapacitet minimal 25 ton – pajisje standarde për ndërtim rrugor dhe operacione të ngarkimit, e cila mund të përdoret si mjet funksional edhe në kombinim me marrëveshje për qira të makinerisë.”

Ky ndryshim do të sigurojë:

Përputhje me praktikën profesionale dhe standardeve të ndërtimit;

Zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe konkurrencës së drejtë;

Përputhje me nenet përkatëse të LPP-së dhe Rregullores 002/2024.

“1 copë dumper deri në 5 ton me matje digjitale.”

1. Pyetjet e parashtruara në kërkesën për sqarim

Cilat janë pozicionet konkrete të paramasës që kërkojnë përdorimin ekskluziv të një dumperi 5 ton?

Cili është funksioni i kërkuar i matjes digjitale dhe si lidhet kjo me ndonjë specifikim teknik të punimeve ose metodë kontrolli të projektit?

A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së, dhe me nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkojnë proporcionalitet dhe lidhje të drejtëpërdrejtë me objektin e kontratës?

A pranohen alternativa të tjera për përmbushjen e funksionalitetit të transportit të lehtë të materialeve, nëse matja digjitale nuk paraqitet si kriter domosdoshmëri teknik?

2. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues dhe vlerësimi kritik AK nuk ka dhënë përgjigje specifike për ndonjë pozicion konkret që kërkon dumper 5 ton me matje digjitale;

Nuk është sqaruar funksioni i matjes digjitale, as lidhja me ndonjë specifikim në projekt ose metodë kontrolli;

Përgjigja është e përgjithësuar dhe nuk përmbush kriteret ligjore për qartësi dhe proporcionalitet teknik.

3. Vlerësim teknik

Transporti i materialeve (zhavor, mbushje, rërë) realizohet zakonisht me ngarkues dhe ekskavatorë që tashmë janë të kërkuar në Aneksin 8;

Dumperët 5 ton janë mjete ndihmëse për punime të specializuara në kushte të veçanta (akses I ngushtë, terren pjerrët) – të cilat nuk janë identifikuar në këtë kontratë;

Matja digjitale nuk është standard teknik i kërkuar në asnjë pjesë të dokumentacionit dhe nuk lidhet me sistem kontrolli apo metodologji për masim sasisor.

4. Vlerësim ligjor

Kjo kërkesë bie ndesh me:

Nenin 7 të LPP-së – vendos kriter joproporcional, që nuk lidhet me objektin e kontratës;

Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së – nuk përcakton nevojë të qartë funksionale dhe nuk ofron alternativa të krahasueshme pa matje digjitale;

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – kriteri nuk është i justifikuar dhe nuk është i lidhur drejt me objektin e kontratës.

5. Kërkesa për rishqyrtim

Duke u bazuar në argumentet teknike dhe ligjore, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të largojë kriterin:

“1 copë dumper deri në 5 ton me matje digjitale”, për arsye se:

Nuk është e justifikuar me ndonjë pozicion konkret në paramasë;

Matja digjitale nuk është kërkesë funksionale e parashikuar në dokumentacionin teknik;

Te largohet pjesa “matje digjitale”

Shkel parimet e proporcionalitetit dhe barazisë, të garantuara me LPP dhe Rregulloren 002/2024.

“Copë makineri për grryerje dhe përpunim të asfaltit me peshë minimale 42 ton.”

1. Pyetjet e parashtruara nga OE

A është e domosdoshme makineri me peshë 42 ton për realizimin e pozicionit 2.01 të paramasës?
A ka specifikime për trashësi ose sipërfaqe që justifikojnë pajisje kaq të rëndë?

A mund të realizohen këto punime me makineri më fleksibile (10–20 ton), të zakonshme për ndërhyrje të këtij lloji?

A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkojnë proporcionalitet dhe lidhje të drejtëpërdrejtë me objektin e kontratës?

2. Përgjigja e AK dhe vlerësimi kritik

AK nuk ka dhënë përgjigje të saktë për lidhjen midis kërkesës për makineri 42 ton dhe pozicionit 2.01;

Pozicioni i vetëm që përfshin grryerje asfalt është 2.01:

“Demolim i asfaltit ekzistues së bashku me skajorët dhe transporti në deponi deri në 15 km.”

Nuk ka sqaruar: trashësinë e asfaltit, sipërfaqen për t’u përpunuar, ose arsyen pse pajisje më të vogla (10–25 ton) nuk mund ta realizojnë detyrën.

3. Vlerësim teknik

Në praktikën inxhinierike, grryerja e asfaltit me trashësi standarde 10–15 cm për ndërhyrje rrugore lokale realizohet me makineri 10–20 ton;

Pajisjet më të lehta janë: më fleksibile, përdoren gjerësisht për punime të këtij lloji, më të përballueshme për operatorët ekonomikë;

Kërkesa për makineri 42 ton është klasifikuese si e rëndë industriale, e zakonshme për rrugë nacionale ose asfalt strukturor të shumëfishtë – jo e nevojshme për këtë projekt.

4. Kërkesa për rishqyrtim

Duke u bazuar në argumentet teknike dhe ligjore, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të ndryshojë kriterin:

Zëvendësimi i makinerisë 42 ton me makineri grryese 10–20 ton, për sipërfaqe totale 750 m².

Arsyet:

Nuk është e justifikuar me pozicion konkret në paramasë;

Makineritë më të lehta plotësojnë nevojat funksionale të punimeve;

Kërkesa aktuale është joproporcionale dhe kufizuese, duke shkelur:

Nenin 7 të LPP-së (proporcionalitet dhe konkurrencë të ndershme);

Nenin 59.3 dhe 67.6 të LPP-së (alternativa funksionale të pa përjashtuara);

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 (kriteret teknike të lidhura me objektin e kontratës).

ngjeshësen hidraulike 900–1000?kg bazuar në informacionin që keni dhënë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM – NGJESHËS HIDRAULIKE 900–1000?KG

1. Përshkrimi i kërkesës në Dosjen e Tenderit:

Në Dosjen e Tenderit kërkohet një ngjeshëse hidraulike e montuar në ekskavator, me peshë 900–1000?kg.

2. Pyetjet zyrtare të parashtruara nga Operatori Ekonomik (OE):

A kërkohet domosdoshmërisht që ngjeshësja të jetë hidraulike dhe e montuar në bager, apo pranohet edhe ngjeshëse pneumatik ose e pavarur në strukturë të dedikuar për përdorim sipërfaqësor me forcë të ngjashme goditëse?

A ekziston ndonjë pozicion në paramasë që përcakton qartë nevojën për ngjeshje të thellë të shkëmbit apo prishje të strukturave të ngurta që kërkon domosdoshmërisht pajisje të montuar në bager?

A është e pranueshme përmbushja e kësaj kërkesë me mjete të krahasueshme me fuqi goditëse të gjashme (900–1000?kg), pavarësisht nëse janë montuar në bager apo janë të pavarura?

3. Përgjigja e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe vlerësimi kritik:

AK nuk ka dhënë përgjigje specifike që të bëjë dallim teknik ndërmjet pajisjes së kërkuar dhe alternativave të vlefshme.

Nuk është identifikuar asnjë pozicion në paramasë që kërkon përdorimin e pajisjeve për prishje të strukturave të ngurta apo ngjeshje të thellë të shkëmbit.

Nuk është bërë dallimi ndërmjet pajisjeve të montuara dhe atyre të pavarura, përderisa forca goditëse dhe kapaciteti teknik mund të jetë i njëjtë.

Kerkojme të formulohet kërkesa NGJESHËS HIDRAULIKE min 1000?KG

një makinë për saldim të gypave PVC-HDPE me diametër Ø900–Ø1200 mm.

2. Pyetjet e parashtruara nga Operatori Ekonomik (OE):

Cilat janë pozicionet specifike në paramasë që kërkojnë përdorimin e makinerisë për saldim të gypave Ø900–Ø1200 mm dhe a mund të identifikohet materiali dhe lloji i lidhjes së kërkuar për

gypat përkatës?

A ka ndonjë kërkesë që vendosja e rrjeteve të ujit të madhësive të tilla të kërkojë saldim, apo mund të përdoren alternativa si lidhje me elemente gome, mekanike ose gypa të paravendosur?

A është vendosur kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores Nr. 001/2022 të ndryshuar me 002/2024, që kërkon që kriteret të lidhen ngushtë me objektin dhe përmbajtjen konkrete të kontratës?

3. Përgjigja e dhënë nga AK dhe vlerësimi kritik:

AK nuk ka dhënë përgjigje që identifikon ndonjë pozitë në paramasë që përfshin punime me gypa Ø900–Ø1200 mm;

Nuk është sqaruar nëse kontrata përfshin tubacione presioni të mëdha plastike që kërkojnë saldim të specializuar;

Nuk është trajtuar mundësia e përdorimit të metodave alternative të lidhjes, si:

lidhje me unazë gome (push-fit),

lidhje mekanike me flange ose manikë,

gypa të paravendosur me lidhje të integruar

Në paramasë nuk figurojnë pozicione që përfshijnë vendosjen e gypave me diametër Ø900–Ø1200 mm të llojit HDPE ose PVC;

Nuk përmendet saldim i tubacioneve me diametër të madh, rrjet presioni apo ujësjellës industrial;

Pajisja është specializuar për rrjete rajonale, kolektorë presioni të mëdhenj industrial dhe ujësjellës qytetesh – jo për projektet lokale të rrugëve.

4. Vlerësimi ligjor:

Kërkesa për këtë pajisje shkel:

Nenin 7 të LPP-së – vendos kriter teknik të palidhur me objektin e kontratës;

Nenet 59.3 dhe 67.6 të LPP-së – nuk justifikohet nga dokumentacioni teknik dhe nuk ofron alternativa funksionale (p.sh., lidhje mekanike ose push-fit);

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – pajisjet mund të kërkojnë vetëm nëse janë të lidhura drejt me përmbajtjen e kontratës dhe të justifikueshme teknikisht.

5. Kërkesë për rishqyrtim:

Duke u bazuar në argumentet teknike dhe ligjore, OE kërkon që Autoriteti Kontraktues:

Të largojë kërkesën për makinë saldimi për gypa Ø900–Ø1200 mm, për arsye se:

Pajisja nuk ka mbështetje në dokumentacionin teknik;

Nuk përputhet me natyrën e kontratës dhe pozicionet në paramasë

Nuk është trajtuar në përgjigjen e sqarimeve;

Shkel dispozitat e LPP-së dhe Rregullores 002/2024.

Stacion Total me system Hybrid për përdorim gjatë realizimit të projektit.

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim:

Cili është lloji konkret i pajisjes gjeodezike që kërkohet për këtë projekt? A pranohet GPS RTK me saktësi nën 2cm apo kërkohet Stacion Total me saktësi më të lartë për vendosje pikat, llogaritje kubaturash, ose kontroll nivelet?

Cilat janë pozitat konkrete të paramasës ku kjo pajisje është e domosdoshme për zbatim? A kërkohet përdorimi vetëm gjatë trasimit fillestar dhe kontrollit gjeometrik apo edhe gjatë gjithë zbatimit të punimeve?

A do të pranohen pajisje të kontraktuara për përdorim përmes bashkëpunimit me gjeodetë të licencuar që posedojnë pajisje gjeodezike të certifikuara, në vend të posedimit të drejtpërdrejtë nga OE-ja?

3. Përgjigja e AK dhe vlerësimi kritik:

AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje specifike për llojin, saktësinë dhe mënyrën e përdorimit të pajisjes;

Nuk ka sqaruar:

Nëse kërkohet GPS RTK, Stacion Total apo tjetër;

Nëse kërkesa është për instrument në pronësi të OE-së apo pranohet përdorimi përmes gjeodetëve të licencuar;

Nëse pajisja duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës apo vetëm në fazat kyçe të trasimit dhe kontrollit; Në paramasë nuk figuron asnjë pozicion që kërkon përdorim të specializuar të një pajisjeje të caktuar; Kërkesa nuk përcakton specifikim minimal teknik, duke krijuar pasiguri dhe hapësirë për interpretim arbitrar nga komisioni vlerësues.

4. Vlerësimi teknik

Përdorimi i pajisjeve gjeodezike është praktikisht standard në projekte ndërtimore;

Zakonisht OE-të kontraktajnë gjeodetë të licencuar nëse nuk i posedojnë pajisjet vetë;

Kërkesa aktuale imponon një pajisje të veçantë pa lidhje të qartë me aktivitetet specifike të projektit, duke e bërë kriterin të tepruar dhe jo proporcional.

5. Vlerësimi ligjor:

Kërkesa shkelë

Nenin 7 të LPP-së – vendos kriter teknik të papërcaktuar dhe krijon pasiguri për operatorët ekonomikë;

Nenet 59 dhe 67.6 të LPP-së – nuk jep specifikim minimal teknik dhe nuk parashikon përdorimin e pajisjeve përmes palëve të treta të licencuara;

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – kriteri për pajisjen nuk është i lidhur drejt me objektin e kontratës dhe nuk është i justifikuar teknikisht.

6. Kërkesë:

Duke u bazuar në argumentet teknike dhe ligjore, OE kërkon që Autoriteti Kontraktues:

Të largojë kërkesën për Stacion Total me system Hybrid nga Dosja e Tenderit, duke eliminuar kriterin e paarsyetuar dhe të panevojshëm teknikisht.

dron i pajisur me sensor LIDAR dhe me mundësi operimi RTK dhe PPK, i regjistruar në Autoritetin e Aviacionit Civil.

2. Pyetjet e parashtruara nga OE në kërkesën për sqarim:

Cila është lidhja konkrete ndërmjet kërkesës për dron dhe ndonjë pozicioni të caktuar në paramasë ose specifikim teknik që kërkon përpunim të të dhënave vizuale ajrore?

A është funksioni i dronit vetëm dokumentues (fotografi/video progresi punimesh) apo edhe si mjet mbikëqyrës teknik për gjeodezi, topografi ose për masë pune?

A pranohen alternativa të tjera, si shërbime të kontraktuara për xhirime ajrore, nëse nuk kërkohet përdorim teknik për mbikëqyrje të detajuara?

A është kjo kërkesë në përputhje me nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe nenin 19.2 të Rregullores 002/2024, që kërkon që pajisjet të jenë në përputhje me objektin dhe nevojat reale të kontratës?

3. Përgjigja e dhënë nga AK dhe vlerësimi kritik:

AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje specifike; nuk është sqaruar:

Nëse droni është i domosdoshëm për punime konkrete në paramasë;

Apo përdoret vetëm për dokumentim vizual të progresit të punimeve;

Nuk është përmendur metodologji monitorimi teknik apo topografik që kërkon domosdoshmërisht këtë pajisje;

Nuk ka pozicione konkrete në paramasë që përfshijnë mbikëqyrje përmes dronit;

Nuk ka specifikime teknike për:

Monitorim gjeodetik,

Mbledhje të dhënash për volum ose sasi përmes fotogrametrisë,

Skanime ajrore LIDAR/RTK të detajuara;

Nëse kërkesa ka qëllim vetëm fotografi/video progresi, ajo mund të sigurohet përmes kontratës me ofrues shërbimi, pa imponim pajisjeje të dedikuara në pronësi të OE.

4. Vlerësimi ligjor:

Kërkesa për dron shkel:

Nenin 7 të LPP-së – kriteri nuk është proporcional me nevojën reale dhe kufizon pjesëmarrësit pa arsye;

Nenet 59.3 dhe 67.6 të LPP-së – nuk ofron asnjë alternativë teknike për përmbushje të funksionit;

Nenin 19.2 të Rregullores 002/2024 – pajisja nuk është e lidhur drejt me objektin e kontratës dhe nuk është e justifikuar teknikisht.

5. Kërkesë për rishqyrtim:

Duke u bazuar në argumentet teknike dhe ligjore, OE kërkon që Autoriteti Kontraktues:

Të largojë kërkesën për pajisje “dron për monitorim ajror” nga Aneksi 8, për arsye se:

Nuk lidhet me ndonjë pozicion të paramasës;

Nuk është e lidhur me metodologji specifike të kontrollit, gjeodezisë ose matjes së progresit;

Mund të zëvendësohet me shërbim të kontraktuar për dokumentim, nëse kërkohet;

Shkel dispozitat e LPP-së dhe Rregullores 002/2024.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjet Nr. 04/L 237, Nr. 05/L-068 dhe Nr. 05/L-092) Neni 7 – Parimet Themelore të Prokurimit Publik

- 7.1: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë
- 7.2: Autoriteti kontraktues nuk duhet të vendosë kërkesa që diskriminojnë ose favorizojnë ndonjë operator ekonomik në mënyrë të pajustificuar
- 7.3: AK është i obliguar të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar. Neni 59 – Kapaciteti ekonomik, financiar dhe teknik/profesional
- Kriteret për kualifikim duhet të jenë: o Të arsyeshme dhe proporcionale me natyrën dhe madhësinë e kontratës; o Të domosdoshme objektivisht për përmbushjen e kontratës; o Jo kufizuese për pjesëmarrjen në mënyrë të panevojshme. Ndryshimet përmes Ligjit Nr. 05/L-068
- Ky ligj përcakton se Autoritetet Kontraktuese nuk duhet të përdorin kushte të panevojshme, që nuk lidhen drejtëpërdrejt me realizimin e kontratës dhe që mund të kenë efekt kufizues apo diskriminues në konkurrencë. Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (e ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024) Neni 27 – Kushtet për pjesëmarrje

- Kushtet për pjesëmarrje duhet të jenë: o Të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës; o Proporcionale dhe të arsyeshme; o Të mos kërkojnë përvojë të tepërt, certifikata jorelevante apo pajisje jo të nevojshme për përmbushjen e kontratës. **KËRKESAT PËR KAPACITETIN TEKNIK DHE PROFESIONAL** Mbështetje ligjore:

- Neni 7, Ligji Nr. 04/L-042: Prokurimi publik duhet të bazohet në parimet e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

- Udhëzuesi 002/2024: Vlerëson si të paarsyeshme kriteret për stafin që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e kontratës. **KËRKESAT PËR PAISJE TË VEÇANTA** Përcaktimi i kërkesave për makineri specifike , që tejkalojnë nevojat reale për kryerjen e punimeve, nuk është i arsyetuar teknikisht dhe kufizon pjesëmarrjen në mënyrë disproporcionale. =

- Neni 28, Rregullorja Nr. 001/2022 (e ndryshuar me 002/2024): Specifikimet teknike duhet të jenë neutrale dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës Mosrepektim në ploteni të : **VENDIM I OSHP :0624/2025** dhe Departamenti i monitorimit- KRPP- se me datën ; 04.06.2025 09:27 i cili ka rekomanduar për korigjim të dosjes.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 25.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0955/25, ndërsa me datë 06.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0955 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “SEFERI-CO” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0955 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendim nr. 1

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën 3.1. Menaxheri i projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 10 vite pas diplomimit, i njëjti duhet të jetë i certifikuar me ISO “Welding supervisor according to ISO 14731;

Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 3.1 & 3.2;

- Certifikatat me ISO “Welding supervisor according to ISO 14731, për pikën 3.1

OE ankues, në ankesën me nr. 2025/624, ka paraqitur si pretendim mungesën e certifikimit me standardin ISO 14731, si dhe përvojën e kërkuar prej 10 viteve të menaxherit të projektit.

Ndërsa, në këtë procedurë ankimore aktuale, si pretendim ka paraqitur vetëm kërkesën për posedimin e standardit ISO 14731, të përcaktuar nga AK.

Argumentimi i pretendimit është i njëjtë me atë të paraqitur në ankesën 2025/624.

Eksperti shqyrtues, në ekspertizën me nr. 2025/625, ka vlerësuar se standardet ISO 14731 dhe ISO 3834 janë standarde që mbulojnë të njëjtën fushë të saldimit. Në këtë drejtim, eksperti ka rekomanduar që në dosjen e tenderit të kërkohej vetëm një standard i tillë, duke shmangur kështu duplikimin e kërkesave.

AK, në formularin për korrigjimin e gabimeve të datës 24.05.2025, ka larguar tërësisht kërkesën për ISO standardet e parashikuara nëpërmjet kërkesës 4 të kapacitetit teknik dhe profesional të FDT-së. Si rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se AK në këtë pikë ka vepruar në përputhje me vendimin e PSH-së. Për pasojë, pretendimi ankimor në këtë pikë konsiderohet i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën 3.4. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

OE ankues ka paraqitur pretendime të njëjta sikurse në ankesën me nr. 2025/624, përkatësisht se kërkesa e parashikuar nuk ka një funksion të qartë teknik në raport me pozitat tjera ekzistuese të ndarjes së përgjegjësi. Gjithashtu, OE ankues ka shtuar pretendimin se kjo kërkesë përbën mbivendosje të kritereve, pa ndonjë justifikim të qartë nga ana e AK-së dhe se OE ankues ka theksuar se AK duhet të lejojë kombinimin e roleve teknike, në rastet kur i njëjti person mbulon të gjitha kapacitetet e nevojshme profesionale.

Eksperti shqyrtues vlerëson se, sa i përket pretendimit të OE lidhur me mungesën e funksionit të qartë teknik të kërkesës në raport me pozitat tjera ekzistuese të ndarjes së përgjegjësi, është dhënë përgjigje në raportin e ekspertizës, tek pretendimi nr. 6, i cili është vlerësuar si jo i bazuar.

Ndërsa, sa i përket pretendimit për mbivendosje të kërkesave me Menaxherin e Projektit dhe Udhëheqësin e Punishtes, si dhe argumentimit të OE-së se AK duhet të lejojë kombinimin e roleve teknike në rast se i njëjti person mbulon të gjitha kapacitetet e nevojshme profesionale, eksperti shqyrtues vlerëson si vijon:

?Sipas FDT-së, për pozitat e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes, është kërkuar:

të dorëzohet një deklaratë në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, për pikat 3.1 dhe 3.2, së bashku me ofertën.

Prandaj, kërkesa e OE-së për kombinimin e roleve teknike do të përbënte një ndryshim të kërkesave të dosjes së tenderit, duke pasur parasysh deklaratat e dorëzuara me ofertë, dhe rrjedhimisht do të paraqiste një ndryshim material të kushteve të tenderit.

Po ashtu, ESH sqaron se sipas nenit 9 të LPP-së, e cila është përgjegjësi ekskluzive për përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur me këtë kontratë, i takon vetëm AK-së. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të RRPP nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi i kriterëve teknike, përfshirë ato potencialisht diskriminuese apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi e plotë dhe ekskluzive e AK-së.

Si përfundim, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimit të OE ankues në këtë pikë pjesërisht i është dhënë përgjigje edhe në ekspertizën 2025/624 dhe se argumentimi i pretendimit shtesë në këtë pikë gjatë administrimit të aktivitetit të prokurimit nuk do të ishte në përputhje me nenin 40.4 të RrPP nr. 002/2024 dhe se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Pretendimi i OE ankues në këtë pikë ka të bëjë me kërkesën 3.6. Bachelor i Diplomuar i Arkitekturës, me përvojë pune min. 5 vite;

OE ankuesi në ankesën 2025/624 ka kundërshtuar tri kërkesa të njoftimit të kontratës:

Certifikata PMP – Project Management Professional

Kërkesa për 8 vite përvojë pune

Pretendimin për diskriminim të kandidatëve të rinj

AK, me Formularin standard për korrigjimin e gabimeve (datë 15.09.2025), ka bërë ndryshime sipas vendimit të PSH 2025/625:

-Është larguar kërkesa për Certifikatën PMP

-Përvoja e punës është ulur nga 8 vite në 5 vite

-Nga dy drejtime të lejuara (Ndërtimtari dhe Arkitekturë), është përzgjedhur vetëm drejtimi Arkitekturë

OE ankues ka ndryshuar pretendimin ankimor, duke pohuar tani se kriteri i përzgjedhjes është kufizues dhe i pajustifikuar, duke përjashtuar kandidatët që kanë përfunduar studimet master në Arkitekturë.

Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas nenit 8.2 të UOPP 001/2023, kërkesat e FDT-se përbëjnë kërkesa minimale të përzgjedhjes. Për të konsideruar një ofertë të përgjegjshme, duhet të përmbushën kërkesat minimale të FDT-së.

Në këtë rast, argumenti i OE ankues se përjashtohet një kërkesë më e avancuar nuk qëndron. Kërkesa më e avancuar nuk përbën kriter të domosdoshëm për përzgjedhjen, dhe për këtë arsye, oferta e kandidatëve me master në Arkitekturë nuk përjashtohet, pasi plotëson kërkesat minimale

të FDT-së.

Si përfundim, eksperti shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje me vendimin e PSH 2025/624 të datës 08.09.2025 dhe se pretendimi i OE ankues vlerësohet se nuk është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimet 4 (Aneksi 8 Lista e Makinerise)

Pretendimet e OE ankues në listën e pajisjeve të kërkuara, sipas Aneksit 8 të FDT-së, janë të njëjta me ato që janë paraqitur në ankesën 2025/624.

Pretendimi për Makinë për saldimin e gypave të PVC-HDPE Ø900- Ø1200 mm nuk ka qene pjese e pretendimeve ne ankesen 2025/624 dhe eshte pretendim i ri.

Gjysëmrimorkio me pesh 65-70 ton - 1 cope

Ekskavator për gërmim min 65 Ton- 2 cope

Cilindër vibruar (Makinë ngjeshese) min. 26 Ton – 1 cope

Ngarkues 3-4 m³- 3 cope

Ngarkues min. 60 ton – 1 cope

Dumper deri 5 ton me matje digjitale – 1 cope

Makineri për prerjen-grryerjen e Asfaltit min 42 ton – 1 cope

Ngjeshese Hidraulike që montohet në ekskavator me peshe 900-1000 kg – 1 cop

Paisje gjeodezike Stacion Total me sistemin Hybrid – 1 cop

Droni i pajisur me sensor LIDAR dhe me mundësi operimi RTK dhe PPK. Droni të jetë i regjistruar në Autoritetin e Aviacionit Civil. – 1 cop

Makinë për saldimin e gypave të PVC-HDPE Ø900- Ø1200 m

Eksperti shqyrtues sqaron se AK, gjatë fazës së tenderimit, i është përgjigjur kërkesës për sqarim të OE ankues përmes shkresës së datës 01.07.2025 (bashkangjitur kësaj ekspertize)

-Sqarim për kërkesën 3.9 të FDT-së

-Sqarim për koken tërheqëse (26ton

-Sqarim për gjysmë rimorkion 65-70 ton

-Sqarim i kërkesave në Aneksin 8 (Lista e Makinerise)

Veprimet e AK-së pas vendimit të PSH 2025/624

AK pas vendimit të PSH përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara ka ndryshuar kriteret e FDT-së për pozicionet:

Kërkesat 2 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kërkesa për numrin e punetoreve

Kerkesat 3.1 ne lidhje me kriterin 4 qe ka te beje me ISO certifikatat

Kerkesa 3.2 Udheheqesi i punishtes

Kerkesa 3.6 Bachelor i diplomuar i arkitektures

Kerkesa 4 Certifikatat ISO 2015, 2018, 28001, 3834-2, 1452-1. BS en 13331-1, SA8000 jane larguar nga FDT

Kerkesat sipas Aneksit 8 te Lista e Pajisjeve jane korrigjuar ne perputhje me verejtjet e paraqitura ne raportin e ekspertizes dhe vendimin e PSH.

Vleresimi i ESH:

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues, në pretendimet e tij për shkeljet e supozuara nga AK, i referohet të njëjtave nene që janë përmendur edhe në ankesën 2025/624. OE ankues pretendon se kërkesat e FDT-së paraqesin shkelje të:

Nenit 7 te LPP-se per shkak se nuk eshte proporcionale, as e qarte, dhe nu kontribuon ne realizimin e kontrates

Nenit 67.6 te LPP-se sepse nuk ofron alternativa teknike te barabarta dhe favorizon nje zgjidhje te vetme, duke e kthyer ne kriter diskriminues

Neni 19.2 te RRPP 002/2024 qe kerkon qe cdo kriter te jete i lidhur drejtperdrejte me permbajtjen e kontrates dhe i justifikuar teknikisht.

Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se AK ne dosjen e korigjuar ne perputhje me verejtjet e paraqitura ne raportin e ekspertizes ka marre veprimet:

Ka larguar nga lista kerkesen per pajisje nen numrin rendor 9 Eskavator per germim mbi 50 ton

Kerkesen per pajisje nen numrin rendor 12 – ngrakues me zingjire min 22 ton

Kerkesen per pajisje ne numrin rendor 18 Kamion kiper per transport te asfaltit te gatshme min 20 ton

Ka zbritur numrin e pajisjeve te kerkuara me kerkesen nen numrin rendor 11 Buldozer

Ka zbritur numrin e pajisjeve te kerkuara ne kerkesen nen numrin rendor 11 ngarkues 3-4m3

Eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues, sikurse në ankesën 2025/624, edhe në këtë ankese i është referuar shkeljeve të nenit 59.3 dhe 67.6 të LPP-së, të cilat nuk janë të aplikueshme në këtë procedurë ankimore, pasi këto nene nuk lidhen me shkeljet e pretenduara nga OE ankues. Për më tepër, për këtë çështje është dhënë një vlerësim edhe në ankesën 2025/624, i cili vlen gjithashtu edhe për këtë ankese.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne baze te nenit 8 dhe nenin 9 të LPP-se, përgjegjësia ekskluzive për planifikimin, përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave që duhet përmbushur i takon vetëm AK-se. Po ashtu, përgatitja e dosjes së tenderit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e AK-së dhe duhet të jetë në përputhje me nenin 11.3, nenin 17.15 dhe nenin 17.17 të Rregullores Nr. 002/2024. Për rrjedhojë, përdorimi apo mospërdorimi i kriterëve teknike, përfshirë ato potencialisht

diskriminuere apo joproporcionale, si dhe ndikimi i tyre në rezultatin e aktivitetit të prokurimit, mbetet përgjegjësi ekskluzive e AK-së.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në përputhje me rekomandimet e vendimit të PSH nr. 2025/624, duke bërë ndryshimet e nevojshme në kërkesat që janë vlerësuar se nuk përputhen plotësisht me LPP-në dhe RRPP 002/2024.

Sidoqoftë, eksperti shqyrtues ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës, pretendimet ankimore të OE ankues (vlerësimet ligjore dhe teknike të përshkruara në ankesë), vendimin e PSH 2025/624, dhe formularin B54 – Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara dhe vlerëson se OE ankues nuk ka argumentuar drejt shkeljet ligjore të supozuara në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa sa i përket vlerësimeve teknike, AK i ka dhënë përgjigje në shkresën e datës 01.07.2025 dhe se OE ankues nuk ka ofruar argument shtesë nga ajo që është prezentuar edhe në ankesën e mëparshme.

Prandaj duke u bazuar në dokumentet shtese të ngarkuara në sistem, sqarimet e dhëna nga AK, përshkrimin e pretendimeve nga ana e OE ankues, eksperti shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në përputhje me vendimin e PSH 2024/624 duke bërë ndryshimet sipas vendimit të PSH dhe se pretendimet ankimore të paraqitura në këtë pike nuk janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë konstatimet në pretendimet ankimore në raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pjesërishte të bazuara për faktin se AK-ja sipas rekomandimit të KRPP-se vetëm pjesërishte ka korrigjuar dosjen (rekomandimet e datës 04.06.2025), e të cilat janë aprovuar si pjesërishte për çka edhe me vendimin paraprak nr. 2025/0624, PSH e ka konstatuar një gjë të tillë duke i shqiptuar vrejtje ZPP-së.

Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues në këtë procedurë i ka falur besimin e konstatimeve dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues ku citon AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Paneli Shqyrtues iu është referuar raportit të ekspertit shqyrtues ku konstatuar se në ankesën e dytë pranë OSHP-së, OE ankues ka shtuar ende pretendime tjera, si dhe ka ndryshuar pretendimin ankimor. Eksperti shqyrtues poashtu sqaron se *AK në dosjen e korigjuar në përputhje me vërejtjet e paraqitura në raportin e ekspertizes*. AK-Komuna e Suharekes ka bërë korigjimin sipas dates: 15.09.2025 B54 Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Korigjimin e procedurës të aktivitetit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA SUHAREKË” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Projekt me bashkfinancim - Ndertimi i devijimit të rrugës Magjistrale në fshatrat Duhël-Bllacë dhe rruges për tek varrezat e reja të fshatit Bllacë-Suharekë” me nr. të prokurimit 624-25-4485-5-1-1.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - SEFERI-CO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: